



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prištine -Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 2.2, pika c të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 9 të Ligjit nr. 03/L-49, për financat e pushtetit lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 27/2008), të nenit 9 të Ligjit nr. 06/L-005, për tatimin në pronën e paluajtshme ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 2/15, shkurt 2018"), dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika c të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.12.2018, merr këtë

VENDIM PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME

Neni 1 Baza tatimore

Rikonfirmohet baza tatimore për prona rezidenciale, komerciale dhe industriale, sipas nenit 1 të Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për tatim në pronën e paluajtshme, 01 nr. 110-246609, dt. 03.10.2016, miratuar në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, nr. 01-463/010253544/17, më 10.10.2017.

Neni 2 Zona tatimore

Rikonfirmohen zonat tatimore sipas nenit 1 të Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për tatim në pronën e paluajtshme, 01 nr. 110-246609, dt. 03.10.2016, miratuar në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, nr. 01-463/010253544/17, më 10.10.2017

Neni 3 Norma tatimore

Në zbatim të Ligjit nr. 06/L-005, për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi i Komunës së Prishtinës cakton normat tatimore për vitin 2019 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë "pronë publike", si vijon:

Faqe 1 nga 3

Kategoria e pronës	Norma tatimore
Për njësitë bujqësore të parcelave	0.15%
Për njësitë bujqësore të objekteve	0.15%
Për njësitë pyjore të parcelave	0.15%
Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.15%
Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.15%
Për njësitë komerciale të parcelave	0.17%
Për njësitë komerciale të objekteve	0.17%
Për njësitë industriale të parcelave	0.17%
Për njësitë industriale të objekteve	0.17%

Neni 4 Vlerësimi i përgjithshëm

Vlerësimi i përgjithshëm për kategoritë tjera, të cilat nuk janë përfshirë në nenin 1 të këtij vendimi, janë caktuar në Raportin mbi vlerësimin e përgjithshëm për Komunën e Prishtinës nga Ministria e Financave.

Neni 5 Çështjet tjera

Çështjet tjera që nuk janë paraparë në këtë vendim, zbatohen në përputhje me Ligjin nr. 06/L-005, për tatimin në pronën e paluajtshme.

Neni 6 Aktet e vendimit

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë: Rregullorja për tatim në pronën e paluajtshme, 01 nr. 110-246609, dt. 03.10.2016, Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për tatim në pronën e paluajtshme, 01 nr. 110-246609, dt. 03.10.2016, nr. 01-463/010253544/17, më 10.10.2017, dhe Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për Komunën e Prishtinës, 09 nr. 2045-1, datë 31.10.2018, të nxjerrë nga Ministria e Financave.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-291303/18, më 11.12.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



ARSYETIM

Siç jeni në dijëni, Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 26 janar 2018, ka miratuar Ligjin e ri për tatim në pronën e paluajtshme (*Ligji nr. 06/L-005*). Ligji është publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, më 15 shkurt dhe ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2018.

Në zbatim të nenit 9 të këtij ligji, parashihet që Kuvendi komunal i çdo komune, cakton normat tatimore për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike.

Në nenin 3 të këtij vendimi, në formë tabelore, kemi vendosur normat tatimore për kategoritë e pronave rezidenciale, komerciale, industriale dhe bujqësore, dhe për njësitë e parcelave rezidenciale, komerciale, industriale dhe bujqësore.

Vlerësimet e pronave të paluajtshme për njësitë: bujqësore të parcelave, bujqësore të objekteve, pyjore të parcelave, rezidenciale të parcelave, komerciale të parcelave, dhe industriale të parcelave, janë caktuar me Raportin mbi vlerësimin e përgjithshëm për Komunën e Prishtinës, 09. nr. 2045-1, datë 31.10.2018 nga Ministria e Financave, si autoritet kompetent për zbatimin e procedurës së vlerësimit, në përputhje me Kapitullin V, neni 17 i Ligjit nr. 06/L-005.

Konsiderojmë se për vitin 2019 nuk ka të dhëna për të ndryshuar bazën tatimore, si dhe lëvizur zonat tatimore të territorit të komunës së Prishtinës, andaj më këtë rast vetëm i rikonfirmojmë të njëjtat, sipas nenit 1 të Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për tatim në pronën e paluajtshme, 01 nr. 110-246609, dt. 03.10.2016, nr. 01-463/010253544/17, më 10.10.2017, miratuar në Kuvendin e Komunës së Prishtinës. Përveç kësaj, Ministria e Financave, në bashkëpunim me Komunën, do të bëjë rivlerësimin e kategorisë së pronave të paluajtshme për njësitë rezidenciale të objekteve.

Andaj, Drejtoria e Financave ka hartuar këtë projektvendim dhe propozon që të miratohet në seancën e radhës së Kuvendit.